

## INTERVISTË ME SKENDER BIKLIQIN

Janjevë | Data: 19 qershor, 2019

Kohëzgjatja: 71 minuta

Të pranishëm:

1. Skender Bikliqi (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Besarta Breznica (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Anita Susuri:** Cilat janë kujtimet ma të hershme të fëmijërisë?

**Skender Bikliqi:** Pikë së pari iu përshëndes, mirë se keni ardhë. Atëherë, prej fëmijërisë une ktu jom vendas në Janjevë, jom qytetar i Janjevës, jom qytetar i Janjevës. Kohën e... une jom i lindun me 26.05.1947 në Janjevë. Ashtu që edhe fëmininë e kom kalu ktu në Janjevë. Ka qenë ni atmosferë shumë e mirë atëherë se ka qenë ni qytet i vjetër e na fëmija si fëmi kemi pasë mjaft shumë... mahalla ka qenë ndoshta, është përafërsisht njiqind fëmi kemi qenë asajde. Ka pasë ni kënaqësi.

Kurse sot, s'mun me i gjetë as dhjetë fmi s'mundesh me i gjetë ksajde nëpër mahallë. Ashtu që e kemi vazhdu jetën. Kur kemi mrrri për shkollë me shku, shkollimin tim, kemi shku vitin e parë... atëherë s'kemi pasë shkolla, kemi pasë ktu në qendër ni objekt prej dy dhomave edhe në xhami edhe në kishë...

**Anita Susuri:** Ktu biblioteka ku ka qenë?

**Skender Bikliqi:** Jo, jo, ktu në xhami, mrena në xhami. Aty kanë qenë tri paralele edhe aty i kemi fillu vitin e parë. Masandej vitin e tretë kemi pasë edhe katër dhoma në objektin e kishës. Atëherë në kohën e komunizmit edhe te kisha edhe te xhamia kanë qenë pronë e shtetit. Po masandej, mas çlirimit tash, po mendoj, edhe ai objekt i kishës edhe i xhamisë janë kthy nëpër objektet e kishës edhe xhamisë.

Faktikisht atëherë, shkolla masandej u hapë. E shkolla ka fillu... ka pasë nxanës mjaft në Janjevë. Atëherë në Janjevë ka qenë, thajse prej '68 - '69, pesë mijë banor, tetë mijë banor janë mrrri, kanë mrrri atëherë edhe e kanë ndërtu ni shkollë. Shkolla e vjetër, po kanë mrrri e kanë ndërtu aty. Ashtu që, na kur kemi qenë... fëminisë po du me tregu që kemi qenë krejt nëpër, ka dy-tre dhoma qashtu se s'ka pasë shkollë atëherë. Edhe e kemi detyru...

Une klasën e katërt e kom kry në gjuhën shqipe, faktikisht edhe është përdorë shkolla e gjuhës shqipe ktu në Janjevë. Faktikisht edhe gjuha turke osht' folë, po gjuhë turke në shkollë nuk kemi pasë, veç në

gjuhën shqipe kemi vazhdu. Masi që e kemi kry vitin e katërt ktu në Janjevë, me shpërnguljen e mjaft qytetarëve të Janjevës, për një vit ndoshta 60 familje janë detyru me ikë në Turqi.

**Anita Susuri:** Cili vit u konë ky?

**Skender Bikliqi:** ‘57 - ‘58 ka qenë ky, kanë shku. Se ka qenë ky, koha e Rankoviqit që ka qenë për armatim edhe ashtu që i kanë rreh gjinjen mjaft edhe janë detyru gjinja për me lëshu prej ktuhit. Edhe kanë shku mjaft. U zvogëlu numri i nxanësve...

**Anita Susuri:** A iu kujtohet juve ajo kohë? Qysh e keni përjetu ju ata?

**Skender Bikliqi:** Po, bash mirë më kujtohet. Shkollën e kemi pasë, ku thashë paralelet në... te kisha, une t’u shku qaty, i kemi pasë ni polic të njofshëm se baba ka punu në komunë, ashtu që ka qenë i Drenasit ni polic edhe kemi pasë kumbari me atë. Edhe ashtu që m’ka marrë... une si fëmi në vitin e parë kom shku atëherë.

Ma ka dhanë ni bisht shpend, ni bisht shpend atëherë u konë me ngjyrë. Edhe unë qaq kom pasë kënaqësi që e kom pa, ma ka dhanë edhe m’ka shti në dhomë aty, po edhe ai armatim që e kanë marrë prej qytetarëve ka qenë para dyrve të policisë aty, se policia ka qenë atje te kisha ni objekt e ka pasë. Ashtu që, më kujtohet ajo kujtesë kurrë s’mund ta harroj që ai armatim që e kanë mledhë prej qytetarëve, une si fëmi në vitin e parë kom shku edhe ma ka dhanë qat’ bisht shpend. E qaty më kujtohet që mjaft janë largu gjinja. Kemi fillu na shkollën. Mas katër vjeçare, po du me thonë që numri u zvogëlu.

Atëherë edhe s’kemi pasë mësusa. Ndoshta, atëherë mësusat që na kanë mësu neve me katër vjeçare e kanë pranu detyrën për me na mësu neve, fillore. Do kurse kanë qenë edhe e ka kry ni kurs, ka ardhë na ka dhanë mësim. Masi që e kemi kry vitin e katërt, tash në gjuhën shqipe s’kishim. U detyrum me shku pesë vetë na shokë të Janjevës me ni fshat Shashkoc ku kanë qenë dy nxanës. Në Prishtinë kemi shku te gjimnazi, atëherë është kujtë, “Ivo Lolla Ribar,” tash është te “Elena Gjika” aty...

**Anita Susuri:** Veç, më falni, para se të vazhdojmë me atë pjesën e shkollës, a bon me u kthy pak te jeta në familje? Familja juj, si e kujtoni ju? Si ka qenë?

**Skender Bikliqi:** Familja jonë, kanë qenë, shembull ktu në Janjevë janë marrë ma shumë me bujqësi Janjeva, qytetarët e Janjevës. Po, kta kroatët janë marrë ma tepër me zanate. Unë si familje, baba im ka qenë gjithë, prej 22 vjeç ka qenë në Prishtinë njo pesë vjet, polic ka qenë, gardian ka qenë i burgjeve. Masandej, u kthy ktu edhe e ka vazhdu jetën e vet në komunë. Kemi qenë ni familje edhe intelektuale në fakt kemi qenë, ashtu që edhe baba. Masandej na djemtë jemi shkollu, jemi, zanatet e ku ta di, qishtu. E mirë, vuajtje s’kemi pasë, e kemi pasë edhe tokë, mixhallartë, edhe kemi qenë në punë. Ashtu që kemi kalu mirë, kemi kalu shumë mirë.

**Anita Susuri:** A iu kujtohen raportet me fqinjët? Ndëretnike atëherë, si kanë qenë?

**Skender Bikliqi:** Edhe ato, në Janjevë nuk kemi pasë probleme, se ktu kanë jetu ma së tepërmi kroat kanë qenë, shumicë kanë qenë. Atëherë kanë qenë turqit dhe romët. Po në Janjevë bashkangjiten edhe tetë fshatëra, se na atëherë kemi pasë edhe komunë ktu, deri në '61-shin ka qenë komuna ktu në Janjevë, ashtu që edhe policinë e kemi pasë. E krejt Janjeva ka pasë ni traditë xehtare, me xehe, me fabrika, me punë, me tulifarë lloje t'zanateve kanë punu kta, kanë punu.

**Anita Susuri:** A iu kujtohet ku ka qenë ajo ndërtesa e komunës?

**Skender Bikliqi:** Po, ajo komunë ka qenë te policia, qaty ku osht' tash po e kanë prish atë komunë, shumë ma vonë e kanë prish ata, e kanë maru aty si komunë. Tani, tash, faktikisht ndër polici e kanë bo se policia u dalë, masi që komuna u bartë në Lipjan, tash policia kalun aty e tash janë dy-tre zyre aty, janë të komunës. Aty është ofiçaria, osht' aty, edhe e kanë vazhdu prej atëhershit kanë vazhdu.

**Anita Susuri:** A është qajo e njejta ndërtesë apo është rrënu ajo ndërtesë?

**Skender Bikliqi:** Qajo komunë ama osht' ndërto pak, osht' renovu. Ajo komuna ka qenë me çardak, me... ka qenë ni vend i hapun aty, tri katëshe, bodrumi ni kat... se aty ka qenë, ndër komunë ka qenë edhe posta aty. E masandej u ndërto edhe posta ma poshtë edhe u prish ajo ndërtesë, atëherë filluese.

Ka qenë qendra që ka pasë ni atmosferë. Janë kanë kafet, janë kanë kasapnicat, janë kanë qebaptoret atëherë që në Janjevë kur ke hi në qendër prej ernave s'ke mujtë me, ndoshta s'ke mujtë me nejt qaq kanë qenë... dikund tetë mishtore kanë qenë t'u pjekë e qishtu. Kta kroatët janë kanë gurbetqarë janë kanë. Kta tanë verën kanë punu gjashtë muj jashtë Jugosllavisë. S'ka pasë vend që s'kanë qenë.

E dimrit kanë ardhë kanë hangër ktu, kanë pasë pare edhe ma tepër se që kta kanë pasë burimin s'besoj që kanë pasë, e dijnë krejt, po mendoj në Jugosllavi kta kanë pasë shumë të ardhura. Secili fëmijë edhe secila familja ka pasë ndoshta tetë fëmijë, dhjetë fëmijë, 18 fëmijë i ka pasë edhe te kroatët po edhe te na shqiptartë ashtu që ka pasë ni gjallnesë, ni jetesë ka qenë ktu e mirë shumë. Kanë pasë vullnet me punu se kemi pasë edhe fabriken, po ka pasë edhe zejtar privat ktu ka pasë.

**Anita Susuri:** Na tregoni pak për jetën kulturore? Për... ktu e di që ka qenë ni bibliotekë në qendër kulturore. A mundeni me na tregu për atë?

**Skender Bikliqi:** Janjeva, drejt me iu thonë, atëherë ka pasë nifarë komunikimi edhe tek të rinjtë po edhe te pleqtë. Për të rinjë na kemi pasë shtëpinë e kulturës. Kanë dhanë filma çdo tre ditë a dy, kemi pasë bibliotekën, kemi pasë qendër rinore, kemi pasë penzionet që merre me mend '67-ën, '57-ën vet me kontributin e vet kta shoqata e penzionerëve e kanë formu prej tre-pesë vetëve. Kanë fillu me ni, që

thojnë, me ni kесе kafe edhe me ni kuti llokum e kanë hap ni zyre si kafe-çaj. Gradualisht në ndërkohë e kanë zgjënu vet me kontributin e vet e kanë bo ni kat. Masandej qaq që kanë pasë të dhanat aty, buxhet, e kanë ndërtu edhe katin e dytë. Edhe sot ekziston ajo shoqatë e penzionistëve me kontributin e qytetarëve që kanë punu aty. Ka pasë shumë punë, se atëherë si penzionist s'kanë pasë tatim e përçata ata kanë qarkullu shumë se edhe e kanë marrë ma lirë. Ndoshta, shembull për ni ditë kur i kanë pasë festat kta kroatët e te tontë, kroatët sidomos sa 200 gajbe janë shitë langje, coca-cola, birra e ku ta di une, qaq.

**Anita Susuri:** Thatë që pas katër vjeçares keni shku në Prishtinë me vazhdu shkollimin. A muni me na tregu për këtë periudhë tash?

**Skender Bikliqi:** Masi që e kemi kry shkollën ktu në Janjevë katër vjeçaren është mbyllur. Është mbyllur me shpërnguljen e qytetarëve në Turqi. Atëherë jemi detyru... ktu ka mbetë veç në gjuhën serbe. Na gjuhën serbe s'dashtëm me pranu niherë, kemi shku për Prishtinë. Prishtinë në shkollën gjimnazi ku është "Elena Gjika" sot, atëherë është thirrë "Ivo Lolla Ribar". Kemi fillu njo ni javë ditë. Të Janjevës kemi qenë njo tre shokë edhe ni fshat Shashkovc ku kanë qenë dy vetë, kemi qenë pesë vetë jemi konë të detyrun me shku aty.

Po jemi shku, siç e dini edhe ju atëherë koha ka qenë jo punësimi, jo puna, ku ta di, të ardhurat s'kemi mujtë me banu, ku me banu. Si shtet s'na kanë mundësu që me pasë ndonjë internat ose ku ta di. Mas një javë dite jemi marrë vesh me ata në shkollë, jemi kthi ktu. Kemi bisedu me prind, çka mujnë me bo, qysh mujnë me bo. Kemi shku në shkollë ktu në Janjevë, ka qenë shkolla serbe. Atëherë i kemi pytë a mujmë me vazhdu shkollën tetë vjeçare ktu, pestën, gjashtën, shtatën, tetën. Na kanë pranu edhe ashtu që na i kemi vazhdu prapë kto në gjuhën serbo-kroate e kemi vazhdu shkollimin tetë vjeçar.

**Anita Susuri:** Në gjuhën shqipe a s'ka pasë...

**Skender Bikliqi:** S'ka pasë. Mas tri vjete u bo prapë.

**Anita Susuri:** E ju thatë që vetëm një javë keni qëndru në Prishtinë apo?

**Skender Bikliqi:** Vetëm një javë.

**Anita Susuri:** Si iu është dukë Prishtina për nji javë?

**Skender Bikliqi:** Prishtina ka qenë shumë mirë atëherë, për rini sidomos. Por veç shkaku që kushte s'kemi pasë na, se s'kemi pasë mundësi se me pasë e kishim vazhdu edhe e kishim mbetë atje. Me pa pasë veç strehim, na për ushqim apet diçka kishim bo, por atëherë strehimi ka qenë... me qira s'ka pasë sikur tash. Sot e jep ni banesë për shembull, mujnë me shku tre-katër vetë me nejt. Atëherë ka qenë shumë e vështirë për banesa me gjetë.

Ashtu që jemi detyru prapë m'u kthy në Janjevë aty edhe e kemi vazhdu tetë vjeçaren. Po masi që e kemi kry tetëvjeçaren, do shokë kanë shku në Shkollë Normale. Unë për veti kam shku... u punësova ktu si nxanës në ekonomi në fabrikë. Fabrika ka qenë në Janjevë. Ka pasë perspektivë edhe e kemi vazhdu na shkollimin ktu, po kemi shku shkollim te shkolla teknike në Prishtinë aty. Na ka dhanë edhe bursa fabrika se atëherë iu vyshin kuadrat. Ashtu që edhe zanatet, kuadrat teknike qishtu... prapë atëherë s'ka pasë në gjuhën shqipe. Mbasi që e kom kry une atë teknikën prapë u hapë gjuha shqipe...

**Anita Susuri:** Do të thotë edhe shkollën e mesme?

**Skender Bikliqi:** Edhe shkollën e mesme që e kom kry në gjuhën shqipe e kom kry atëherë.

**Anita Susuri:** Pasi jeni punësu, si ka qenë atëherë fabrika ku jeni punësu? Cila fabrikë ka qenë? A na tregoni pak për këtë?

**Skender Bikliqi:** Fabrika ka qenë, kjo fabrika e zejës, "Metaliku". Thirret "Fabrika e Metalikut". Unë e kom përjetu edhe ktu, se në Janjevë mrena qëtu ka qenë fabrika po hapësira e vogël ka qenë ajo. Aty ka pasë 300 punëtorë, ktu në fabrikë. Po, në ndërkohë komuna e ka ndërtu ni ndërtesë, po mendoj jashtë Janjevës që atë ndërtesë që e kanë bo e kanë bo në plan që edhe fshatrat me u bashkangjité edhe tjerat prej komunës së Lipjanit, për shembull.

Faktikisht edhe ashtu që kur jemi shpërngulë na poshtë, kemi pasë prej Obiliqit, prej Goleshit, prej Lipjanit, prej Gadimës, prej Ferizajit, prej Pletkoviqit e Banulle e Llugaxhie e kah mos. S'ka pasë fshat që s'ka pasë ndonjë punëtorë në fabrikën e Janjevës, se ka fillu ni përparim ajo fabrika. Prej 300 punëtorëve kemi pasë dikund 800 punëtorë.

Rrogat i kemi pasë mjaft mirë, kuadrat i kemi pasë ashtu që ka ecë puna, kemi punu mirë ka qenë. Se unë masi që e kom kry aty shkollën meniherë na kanë pranu neve. Unë veç '66-ën si punëtor kom qenë atje, si punëtor kam qenë. U kry fabrika osht' shku '67-ën atje jemi shpërngulë. Tri vjet kom punu ktu mrena në qendër të Janjevës...

**Anita Susuri:** E qysh ka qenë atëherë fabrika? Ju na keni tregu që katër kroat e kanë formu, a mundeni me na tregu...

**Skender Bikliqi:** Po, po. Ajo fabrikë... se Janjeva si Janjevë kanë qenë zejtarët po mas çlirimit '47-ën, viti 1947 janë marrë vesh ata zejtarët, nja pesë vet ishin kanë. Njani i ka marrë do mjete, vegla ku ta di, kanë qenë mjeshtrit ma të mirë, ashtu që janë bo një grup. Prej asaj grupe, qendër bash qaty, ni lokal ka qenë dikun katër me pesë, qaty kanë fillu ata. Edhe atëherë si mbas çlirimit, luftën e dytë, kanë fillu menjëherë kooperativat.

Kooperativa bujqësore, kooperativa zejtare, ku ta di, e kta janë regjistru si kooperativë zejtare. Kanë fillu aty gradualisht, kadal, kadal. Se atëherë veç është prodhu në Janjevë luktë e aluminit, tepsijat, sahanat, tenxhere për pasul e për kta krejt kanë fillu atëherë janë prodhu kta ashtu që iu ka ecë edhe puna. E gradualisht tani janë përhapë, kanë fillu për... dyrë të bravave me dorza kta, ku ta di une, e tjera elementet për maqinat e lamjeve të teshave e krejt.

Kemi fillu prej motorrave për kerre e tjera, krejt është masanej. Por, po du me thanë me lidhë me qata që ka fillu se atëherë edhe qata që kanë qenë, “Ivo Lolla Ribar” e kanë bo atë kooperativën po mas ‘57-ës kanë pasë të drejtë, janë regjistru në gjykatë e kanë formu tana e kanë lanë, “Ivo Lolla Ribar” atë fabrikën.

E gradualisht, kadal kadal...

**Anita Susuri:** Fabrikën, a ka qenë “Kardelj”?

**Skender Bikliqi:** Po, Kardelj Filip, tash a Kardelj a Ivo Lolla Ribar aty... po masandej në ‘57-ën e kanë hapë ma tepër janë zgjanu se janë regjistru në gjykatë. Ashtu që, kanë fillu kta edhe e kanë vazhdu deri që numri ka rritë, deri në fund 800 punëtorë.

**Anita Susuri:** Si ka qenë ktu, domethanë kur keni shku në punë? A keni shku gjithë bashkë apo si ka qenë atmosfera në mëngjes apo atmosfera e punës në fabrikë?

**Skender Bikliqi:** Po ktu, shumë mirë atëherë ka qenë ni atmosferë çudi po atëherë ma tepër kanë qenë kta kroatët. Atëherë qysh në ‘55-tën ‘57-ën vetëm dy shqiptarë kanë punu ktu po gradualisht kadal kadal janë bo dikund pesë-gjashtë. Ashtu që, bukën e kanë marrë me veti vet punëtorët, janë shku grup qishtu. Ka qenë ni kënaqësi me gëzim kemi shku, po punon. Shumë ka qenë ni atmosferë e mirë, besa edhe është punu mirë, osht’ punu qashtu... kanë pasë prodhim, kanë pasë shitje edhe shumë kanë fillu me përparu, kanë pasë ni respekt punëtorët, jo sikur tash.

Une vet kom qenë udhëheqës, ndoshta dikund 300 punëtorë i kom pasë edhe krypunëtor se kom qenë edhe udhëheqës ndrrimi, po ke mujtë me komuniku me çdo punëtor. E sot ka ardhë, diqysh na ma vështirë. Sot as me pesë vet s’munesh me komuniku po s’e di, atëherë ka qenë shumë ka pasë respekt, shumë ka pasë... me punu... unë si, e mbaj në mend, si nxanës në ekonomi atëherë që kemi pastru, kemi fshi, kemi punu, çdo maqinë kemi punu s’na ka ardhë marre. Edhe me fshi kemi fshi edhe çmos kemi bo përveç me mujtë me marrë ni zanat na atëherë.

**Anita Susuri:** Para se me vazhdu, deshta me u kthy pak në atë kohën kur turqit, domethanë i kanë largu prej Janjevës, me na tregu për babain e juj kur familjarisht janë largu. A mundeni për atë periudhë me na folë?

**Skender Bikliqi:** Edhe kta du me iu tregu se unë, se babën drejt me të thanë unë sot mixhallarët... mahalla, mahalla quhet “Saraji” edhe mahalla e epërme osht’ ktu knena. Kanë qenë dy mahalla turqi edhe atë, unë mixhallarët e mi, kusheritë që kanë shku sot janë atje në Turqi, dikund 60 shtëpi janë, 60 familje janë. Na, baba ka pasë punu në komunë si referent ka qenë i mbrojtjes, ushtarak. Edhe babën atëherë s’e kanë leju me shku në Turqi, shkaku që munesh ti me dhanë deklarata për Jugosllavi diçka edhe s’na kanë leju me shku. Baba ka thanë, “Po, s’po më lejoni, po. Une du me vazhdu punën”. Edhe punën dojshin me ia hupë babës atëherë që, “Une,” thotë, “a jeni qata njerëz që une jetoj ktu edhe ta vazhdoj punën time, une prej pune nuk largohna edhe jes ktu me punue”. Ashtu që, kemi mbetë edhe sot e atë ditë nuk jom pishmon që kam mbetë. Tash, mjaft mysafirë vijnë te na prej Turqie edhe ata thojnë, “Shyqyr që keni mbetë ju barem po kemi ku me ardhë te ju”. Qishtu ka qenë ni kënaqësi që edhe kur kanë ardhë kanë pasë mbështetje ku me ardhë.

**Anita Susuri:** Kur keni qenë ju i ri, si ka qenë Janjeva? A ka pasë kafene? A keni dalë nëpër kafene? Si ka qenë ajo jeta kulturore, jeta e natës?

**Skender Bikliqi:** Kohën e rinisë, drejt me të thanë, Janjeva e ka mbajtë atë traditën e vjetër. Si të ri na s’kemi guxoftë me dalë në kafe, ku ta di. Se janë kanë ktu njo pesë-gjashtë kafe edhe ato kafet që kanë qenë, kanë qenë kafja e esnafëve. Ku kanë pasë tregi, ku kanë nejtë, ku s’ke pasë zhurum, ku kanë qenë politikanët kanë ardhë. Po ka qenë edhe kafja e ktyne që kanë pi, kanë qenë kafet mesatare po na si rini jemi mbështetë atëherë ma shumë në filma.

E kemi pasë shtëpinë e kulturës, bibliotekën edhe faktikisht janë marrë shumë rinia me sporte, me bibliotekë, me filma. Ashtu që, kemi pasë... ni qendër ka qenë e zhvillume Janjeva. Edhe, si rini, besa edhe pak pare kemi pasë ma tepër se kanë punu rinia, kanë punu edhe jashtë kohës kanë mujtë me punu nëpër kta zejtarë. I kanë marrë të shtunëve, të dilleve ose jashtë orarit... iu ka vy ktyne punëtorëve, ktyne zejtarëve edhe kanë pasë, si pare si mbështetje edhe kanë kalu mirë. Kemi kalu të gjithë mirë në Janjevë.

**Anita Susuri:** Te shtëpia e kulturës thatë që aty keni shiku filma, çfarë filma keni shiku? A iu kujtohet që keni shku, si ka qenë?

**Skender Bikliqi:** Kanë qenë filmat ma tepër jugosllav, luftat e kto qysh janë zhvillu e krejt. Qatëherë kanë qenë qato filmat ma tepër, s’kanë qenë sikur sot i merr filmat, cilin film po don e inçizon. Atëherë janë kanë të programum cilat filma munësh me kqyrë ti nëpër kto shtëpitë e kulturës.

**Anita Susuri:** A kanë dalë edhe femrat apo Janjeva ka qenë vend ku kanë dalë në kafe meshkujt ose me shëtitë?

**Skender Bikliqi:** Në Janjevë, femrat shqiptare e turke s’kanë dalë, po mendoj, nëpër shtëpinë e kulturës e te kroatët kanë dalë. Kur kanë qenë kanë dalë kroatët.



**Anita Susuri:** Sa i përket jetës kulturore, na tregutë domethanë edhe për bibliotekën e këto, po tjetër, domethanë edhe sporti. Si është zhvillu kjo te t'ritë? Sa të ri janë marrë me sport? Me çfarë sporti janë marrë? Ku janë organizu ato?

**Skender Bikliqi:** Kto sporte na i kemi pasë, sport si sport, po mendoj Janjeva, vend s'kemi pasë qaq shumë po drejt me të thanë kur kemi qenë në fabrikë prej '66-ës, 67-ës poshtë kur kemi zbritë, e kemi bo ni stadium aty që edhe Janjeva ka ardhë. Na, për kohën e futbollit jemi shku, për shembull në fshatrat Akllap e Banullë e Lipjan e... Kemi pasë na... gjithë futbolla ka lujtë rol në Janjevë edhe më kujtohet mirë edhe fabrika kur kemi qenë kemi pasë fitu, drejt me të thanë, e une i kom pasë dhanë edhe do medalje.

I kemi shkri vet në fabrikë, që me pasë ditë i kom pasë do medalje '77-ës, '79-ës që i kemi shpërnda, qato vet i kemi shkri na. Ato medalje i kemi përpunu, ashtu që kemi pasë... masandej prej atuhit edhe kena çu pije, heje. Qitu ka qenë ni kafe, përmi neve ka qenë ni kafe. Unë thashë, kafet kanë qenë, ashtu që i kom si femra si mashkuj që kemi punu, kanë punu, rinia kanë pasë dëshirë që të gjithë me u marrë me sport, me futboll, me qisi basketboll e qishtu.

**Anita Susuri:** E sa i përket bashkëjetesës, domethanë turqit, kroatët. Si kanë qenë këto marrëdhëniet fqinjësore?

**Skender Bikliqi:** Marrëdhëniet kanë qenë mirë, s'kemi pasë problem. Ashtu që, se ktu ka qenë edhe tregu, ktu Janjeva e kemi pasë edhe xhaminë edhe u kanë mbetë qysh prej osmanlive se ka qenë edhe tregu të premten po edhe në xhami kanë ardhë fshatrat mjaft në Janjevë i kanë kry puntë, kanë bo pazaret i kanë kry, e kanë falë xhumanë ktu. Ashtu që, kemi pasë gjithë kontakt edhe me fshatrat tjera.

Po edhe martesat, Janjeva na i kena pasë gjithë me fshatra i kemi pasë martesat. Unë nanën e kom prej Mramorit, grunë e kom prej ni fshatit Bukovicë, tjetër e kanë pasë prej Gadime, prej Akllapi, prej, tona katuneve që janë kanë marrë, besa edhe me thanë, atëherë kanë pasë nifarë kënaqësie që me dhanë ni vajzë a diçka, me ardhë në Janjevë ose me u miqasu osht'... qishtu ka vazhdu jeta ndërmjet fshatrave edhe qyteteve të Janjevës.

**Anita Susuri:** Na tregoni pak për kohën masi e keni përfundu shkollën e mesme, çka keni bo atëherë?

**Skender Bikliqi:** Masi që kemi kry shkollën e mesme, unë kam qenë edhe marrëdhanie pune meniherë, masi e kom kry mot mot kom punu, jom martu, kom kriju familje...

**Anita Susuri:** A mundeni me na tregu cilat tradita janë përdorë te turqit? A kanë qenë, domethanë, të njejtat si te kroatët e shqiptartë? Si kanë qenë ato traditat e dasmave?

**Skender Bikliqi:** Dasmat, traditat e tona e kto kanë qenë njëjtë si te shqiptartë. Na, njisoj e kemi pasë traditën e te kta kroatët, po edhe kta e kanë pasë ni traditë të vjetër. E kanë pasë veshjen e, me dimija me ato shallvare, ku ta di do jeleka dilshin nëpër qendër. Ata e kanë pasë zakonisht me dalë te kisha, mu kurorëzu aty e kanë dalë çarshisë nëpër qendër kudo me muzikë. Kanë bo muzikë mjaft të mirë. E kanë pasë muzikën gjithë të mirë, ushqimin e mirë, pijet e mira i kanë pasë kta kroatët. E te na, prapë edhe te na dasmat kanë fillu prej të enjtes.

## Pjesa e Dytë

**Skender Bikliqi:** Na, dasmat kanë fillu edhe te na prej të enjtes, ashtu që ka fillu dasma, premtën e shtunen e të dillen. Deri të hanën që u kry ai kulaçi e kanë qitë pogaqe e llokuma e ku ta di unë. Ajo traditë ka qenë njëjtë sikur në fshatra sikur te na, njëjtë ka qenë.

**Anita Susuri:** Domethanë, traditat e njëjta sikur sot...

**Skender Bikliqi:** Të njëjtat i kemi pasë sikur shqiptartë.

**Anita Susuri:** E, sa i përket, a keni shku, domethanë, ktyne marrëdhënieve, e thashë edhe ma herët ndërfaqinjësore, a keni shku ju nëpër dasmat e kroatëve? A iu kanë thirrë? A keni pasë miqësi?

**Skender Bikliqi:** Po. Kta kroatët kur e kanë bo dasmën kemi shku. Na kanë thirrë gjithnjë po edhe na kemi pasë kur kemi thirrë nëpër dasma. Une kur jom martu, drejt me thanë, kanë qenë, pesë kroat kanë qenë edhe ata me kerre se atëherë s’kemi pasë na kerre. Kanë ardhë me gjithë kerre kemi shku me e marr nusën. Kta kanë ardhë. E si nëpër dasma, si nëpër dekë gjithë kemi shku te kta. Edhe ata vijnë, edhe sot vijnë edhe atëherë kanë ardhë, po edhe na gjithë kemi shku. Sidomos na që kemi qenë vendas kemi shku nëpër dasma edhe nëpër, kur kanë pasë rast vdekje e të pane, ku ta di kemi marrë pjesë qishtu nëpër dasma te kta.

**Anita Susuri:** Pas punës, domethanë, që e keni zhvillu në “Metaliku” si ka vazhdu pastaj jeta juj? A jeni... a keni qenë i koncentrum në atë punën që e keni bo apo jeni angazhu edhe diçka tjetër?

**Skender Bikliqi:** Me iu tregu bash, mirë e cekët ju ata që na kur kemi fillu atje aty kanë qenë thuj që 98 përqind kroatë. Në ndërkohë kanë fillu edhe serbtë me ardhë, po me ardhjen tonë, dikun ‘69-ën, ‘70-ën kemi fillu me i dhanë do kualifikime të nalta në Obiliq. Atëherë ka qenë Ismail Dumoshi, atëherë inxhinier ka qenë edhe jemi detyru... por unë s’kam qenë kurrë vetjak. Ashtu që, kom pasë, shoqni kom pasë edhe kom shku e kom kry kualifikimin e naltë atje. Mbasi që e kom kry kualifikimin e naltë i kom çu edhe katër shokë tjerë. Se atëherë kualifikime s’kanë pasë, si te kroatë si te kta s’kanë pasë kroatë me kta fabrikat që me shkollë të, nashta fillore kanë qenë, udhëheqësa kanë qenë.

Po, kur dul ai ligj, tamon që, pa marrë parasysh, e ki kualifikimin munesh me marrë edhe postin e vendit të punës. Ashtu që fillim, une si kom fillu, po mendoj si e kom kry kualifikimin e naltë mas ni kohe, mas tri vite e kom marrë vendin e punës ku m'ka taku. Po edhe ata shoktë gradualisht, edhe krejt na që e kemi krye ato kualifikime të nalta kemi ardhë nëpër vende, poste. Mbasi që kemi ardhë aty drejt me thanë ka fillu ni gjallnesë. Se atëherë kanë qenë jo partia, jo sindikata, jo pleqësia edhe në ato detyra jemi kyç meniherë. Edhe kemi fillu, kemi startu, kemi marrë djem të rinj.

Mandej ku kemi qenë, kur kam qenë udhëheqës une, meniherë kom fillu me i marrë të rinjtë me i aftësu, me i shkollu, me i drejtu ku duhet e çfarë kualifikime me marrë, cilën degë. Edhe ka fillu Janjeva me u ngjallë. Me ardhjen edhe të ni drejtorit, Luan Krasniqit prej Lupqit ka pasë ardhë atëherë, drejtor i parë teknik. Ka ardhë, inxhinier ka qenë. I vetmi ai shqiptarë që na ka ardhë e gradualisht. Ashtu që, kemi fillu me startu, kemi startu, kemi fillu me punu edhe kemi mrrri deri që u mbush me kombësi shqiptare aty.

**Anita Susuri:** Në cilat vite ma së shumti u mbush kështu me kombësi shqiptare?

**Skender Bikliqi:** Në të '80-at është mbushë. Deri në të '80-at kemi pasë, por jo qaq shumë edhe në të '80-tat kanë fillu me u mbushë me shqiptarë.

**Anita Susuri:** E në atë kohë që po e përmendni tash si ka qenë Janjeva? Çarshia, ktu, a ka qenë ma njejtë se kur keni qenë ma i ri a çka ka ndryshu në atë periudhë?

**Skender Bikliqi:** Janjeva gjithë ka përparu, po mendoj janë shumu, janë formu zejtarët ma tepër, janë hapë bizneset ma tepër, të ardhuna ka pasë ma tepër, fabrika u hap... edhe kta du me cekë me iu tregu se e djinë edhe komunalët, në komunën e Lipjanit janë dikun 70 fshatra po sikur Janjeva që ka pasë tatimet, kontributet... krejt ata fshatra që kanë qenë si Janjeva s'e kanë pagu as rrymën... se na, rryma ka qenë atëherë me Ferizaj u kanë lidhë. E Ferizaji edhe komuna thojnë që gjithë ato katune sa Janjeva s'kanë pagu rrymë elektrike, s'kanë pagu tatim. Ashtu që, çdo shtëpi ka pagu tatim edhe tatimet kanë qenë shumë të mdhaja atëherë si te zejtarët e zanatlitë e... ashtu që po i kanë pagu i kanë përballu krejt, po thom që ka pasë gjallnesë.

Po, po du me iu tregu, ju jeni pak ma të ri, ajo është pak ma vonë qitash. Shembull, kur kanë dashtë me marrë, kur u hapën markat, Janjeva me fshatrat me ble ni traktor osht' dashtë me dinarë ose me marka. Se markat kanë qenë prej punëtorëve që kanë shku në perëndim me punu, ata kanë pasë pare marka. E qato marka kanë ardhë në Janjevë me i thy se s'kanë mundësi me i thy kërkund. Nashta me 20 mijë mark, me 30 mijë mark, me 50 mijë mark janë ardhë ktu i kanë thy paret dinarë me i bo, me i ble traktorat.

**Anita Susuri:** Domethanë, zejtarët kanë qenë ata ma të pasur apo...

**Skender Bikliqi:** Ma të pasur, zejtarët, kroatë kanë qenë, kroatë kanë qenë.

**Anita Susuri:** Na tregoni se iu veta, iu pyta ma herët për Çarshinë. A ka qenë e shtrume me asfalt apo kalldrëm? Ato vitet, domethanë të '80-ta, '70-ta.

**Skender Bikliqi:** Ktu, Janjeva, deri në Lipjan kanë qenë me gurë. Osht' ni gurëthyes ktu përmi në Janjevë, atëherë i kanë detyru me bajtë, si komunë, i kanë caktu edhe shkollën kur e kanë ndërtu, secila familje kush ka ki, ka pasë kuaj, e kanë bajtë ka ni metër gurë e kanë shtru. Shkollën e kanë ndërtu me gurë, rrugën deri në Lipjan...

**Anita Susuri:** Shkollën e vjetër?

**Skender Bikliqi:** Po, shkolla e vjetër me gurë krejt ka qenë edhe përtej në Lipjan ka qenë atëherë me gurë si kalldrëm. Me gur ka qenë e masandej u ndërtu asfalti tana kta i kanë rrugtë e vogla, kta janë kanë qysh ma herët kanë shtru kalldrëm, krejt me gurë. Edhe për qata është edhe gurëthyesi. Po tash edhe xhamia që është ndërtu edhe gurtë, krejt e kanë marrë këtë historinë e vjetër, ma tepër kanë shku me gurë me punu.

**Anita Susuri:** Edhe xhamia është me gurë e ndërtume apo?

**Skender Bikliqi:** Tash edhe xhamia krejt. Ato muret e krejt, që me mbetë, që kur erdhën ata prej Turqie, se koka vendi ktu, muret janë krejt me gurë, ndoshta i keni pa? Qe ktu menihere me dalë i shihni me gurë e deri naltë janë muret me gurë. Në qat' mahallë me shku te naltë e shihni krejt me gurë, se ka pasë gurë ktu edhe ma tepër i kanë përdorë edhe ma të fortë qashtu.

**Anita Susuri:** Dashta edhe me iu vetë për tipet e shtëpiave, a kanë qenë të dominume prej kulturës turke? Si janë dukë shtëpiat në atë kohë?

**Skender Bikliqi:** Edhe ata, Janjevën drejtë me thanë e kanë marrë atë stilin e osmanlive. Se kom pasë une shpesh vizitor, kanë ardhë edhe prej Prizrenit e ktuhit... ti me pasë hi në shtëpia të tyne, janë kanë ata të qinisne, tavanat e kta. Janë çuditë edhe ata krejt. Prej osmanlive. Krejt kanë qenë ato objektet, shtëpiat...

**Anita Susuri:** Drurit të punum apo si?

**Skender Bikliqi:** Drurit të punume e qishtu, lllamperitë e ku e di, shumë krejt kanë pasë...

**Anita Susuri:** E pamja e jashtme a ka qenë shtëpi ni katëshe a dy katëshe? A ka pasë çardaka?

**Skender Bikliqi:** Po, po, po. Ktu, si te kroatët si te na ma tepër me çardaka kanë punu. Kanë qenë çardakat, kanë qenë drunat aty, kanë ndejtë. Dy katëshe, ni katëshe, dy katëshe kanë shku, jo shtëpi të mdhaja qashtu. Veç dy katëshe gjithë ma tepër janë kanë aty.

**Anita Susuri:** Deri në cilën kohë iu kujtohet që ka qenë kështu atmosferë e mirë në Janjevë? Kur ka fillu me u lëshu Janjeva?

**Skender Bikliqi:** Ktu kanë qenë deri vitin 1990. Ka pasë gjallnesë, ka pasë punë, ka pasë përfitime. Mbas të '90-ës, si edhe neve na largun prej punës, po edhe kroat fillunë me u shpërngulë prej Janjevës.

**Anita Susuri:** A mundeni me na tregu pse ka ndodhë kjo? Si e keni përjetu ju?

**Skender Bikliqi:** Na, drejtë me thanë, atëherë punën shumë mirë e kemi pasë aty po situata politike ka qenë, besa edhe kanë fillu atëherë, qysh minatorët kur fillun në Trepçë jemi konë pas bashkangjitë të gjithë na. Atëherë ka fillu ni agresor serb te na, jo diferencimin me bo, jo ku ta di, ku kanë shku kta shqiptartë e ku kanë marrë pjesë e, ashtu që kemi pasë mjaft probleme. Po, edhe ato i kemi përballu. M'kanë pasë qit bile mu komision po s'kanë mujtë kurgjo, sidomos për Janjevën, muj me thanë kurgjo s'kanë mujtë... edhe komuna vet e caktunë, gjoja se njo ka qenë, ka marrë pjesë nëpër do greva edhe e kanë largu prej partisë. Se atëherë kur të largon prej partisë ose që s'je kanë në parti edhe prej pune të ka largu.

Po, atëherë edhe prej partie u largum krejt ashtu që... po deri në vitet e '90-a Janjeva shumë ka qenë... xhumanë, kur ka qenë treg ktu, se në treg kanë ardhë prej Suharekës, prej Sudeqanit, prej Mamushe, prej kah mosit. Ktu, çka osht' pru në treg mbrapa nuk është kthy t'u shitë, se kanë qenë, kanë pasë pare, kanë pasë të holla, kanë pasë punë. Ashtu që, kush vike në Janjevë osht' kanë i kënaqun, janë kanë të kënaqun. Edhe ka pasë ni besim atëherë ka pasë.

Ti, para neve ktu ka qenë tregu, prej ktuhit nëpër çarshi nëpër qendër krejt ka qenë... ata kanë ardhë në mramje prej Suharekës, prej Sudeqanit, prej Mamushe, i kanë lanë ktu krejt mallin, me domate, me speca, me boston, me kta, krejt i kanë lanë, kurrë kërkush s'i ka prekë. Edhe kur u çum në mëngjes me e pasë marrë dikush u shku i ka thanë që, "Kqyre, ta kom marrë ni boston, e kom matë, qikaq të kom pasë". E sot nuk osht' qajo hiç. Ka pasë, unë po të thom, ka pasë ni respekt. Ktu ka ndodhë edhe dy herë që iu kanë hupë kah dhetë mijë mark gjinve. I kanë çu në kishë edhe në xhami.

**Anita Susuri:** Në kohën para viteve të '90-a kanë ndodhë kto?

**Skender Bikliqi:** Po, para viteve të '90-a. I kanë gjetë paret në Çarshi, i kanë çu edhe në xhami edhe në kishë. Janë lajmëru gjinja, e qishtu ka qenë.

**Anita Susuri:** A mundeni me na tregu pak për “Metallcin”? Ka qenë fabrikë e madhe po po më duket që edhe në disa vende të tjera ka pasë degë të saj...

**Skender Bikliqi:** Po, na masi që e kemi fillu, drejt me thanë, kanë fillu do kuadra me ardhë mjaft se investimet edhe kanë qenë ku ka pasë kuadra pak ma tepër. I kemi pasë na kuadrat, krejt, thuajse djemtë e udhëheqsave kanë qenë. Qysh ka qenë djali i Fadil Hoxhës, Metush Ballabanit, nifare Gëzim Kazazi, kta të Dobrajes kanë qenë. Ai, ka ardhë ni drejtor gjeneral prej amortizerave, ka qenë edhe ni boshnjak prej Plavës ka pasë ardhë edhe ai ka qenë i aftë. Edhe ashtu që kemi fillu mjaft.

Kanë ardhë shumë inxhinierë kanë ardhë atëherë edhe puna na ka shku marë. Kanë qenë investime të mdhaja kanë qenë. Prej atyhit ka pasë ni fabrikë në Skenderaj e plastikës. Ata kanë punu me lodra po na e kemi hapë atje në Skenderaj ni fabrikë karrika e tavolina. Qasi karrika e tavolina s'ki hala kërkund edhe na ka shku. Masandej tregtinë e kemi hap në Prishtinë te Ljublanska Banka, e kemi pasë marrë këtë objekt që mjaft, kemi fillu me startu me punu.

**Anita Susuri:** A ka qenë kjo në kuadër të fabrikës apo...

**Skender Bikliqi:** Në kuadër të fabrikës ka qenë, në kuadër të fabrikës ka qenë.

**Anita Susuri:** Në cilat vite kanë ndodhë kto?

**Skender Bikliqi:** Kto kanë qenë para... '83-tën, '85-tën qaty kanë qenë. '82-shin kanë qenë që kanë fillu me ardhë kta kuadrat prej Prishtine.

**Anita Susuri:** A iu kujtohet koha, domethanë pas viteve të '90-ta, kur kroatët kanë fillu shpërnguljen? A muni me na shpjegu pak ma shumë shpërnguljen?

**Skender Bikliqi:** Shpërnguljen e kroatëve, unë iu thashë, edhe neve kur na largunë edhe ata janë kanë pak të brengosun që... jemi mësu na në Janjevë gjithë bashkarisht me punu, me gjallnu po edhe ata kanë pasë ni frikë. Ashtu që kanë vazhdu po dikun në 1998, '97, tash 1995 që fillunë Kroacia me luftu me serbët atëherë se faktikisht kta kroatët shumë janë kanë të lidhun atje. Se kur fitoi ai Tuxhmani kta Janjeva kanë qenë biznismena të mdhoj atje edhe i kanë pasë pre nja dy bika [lopë] e tana ktyne iu dul zani që, qy kta kroatët e Janjevës po i përkrahin atje kroatët.

A ata kanë pasë shumë lufta në Vukovar shembull me kta kroatë. Edhe kanë pasë ardhë ktu, Shesheli me ni grup të vet, me polici... edhe Zoran Zinxhiçin e vrajtën. Ktu në Janjevë kanë ardhë që kërkund nuk kanë shku edhe kanë thanë, “Që kta duhet me i pushkatu. Kta, kroatët e Janjevës, se kta i kanë përkrah atje edhe kanë luftu kundër neve”...

**Anita Susuri:** Shesheli?

**Skender Bikliqi:** Shesheli. Edhe ashtu që kta mrena natës edhe mrena ni javë dite janë shpërngulë mjaft.

**Anita Susuri:** A iu kujtohet ajo kohë?

**Skender Bikliqi:** Po, më kujtohet, më kujtohet kur kanë ardhë. Bile me ni polic qit' rrugën ktu e ka pasë plagos ni shqiptar edhe ni gru. Ai djali tani ka pasë shku në Zvicërr e ktu për qef, për inati, me gomar kanë qenë ata shembull, nji tu shku për Shashkocv atje e kanë plagos atë grunë edhe atë djalin. Edhe prej atyhit kemi fillu, se aty fillun kta edhe kroatët u frikësun. Vetë kroatët thojshin, "Lufta e parë ka qenë, Lufta e dytë ka qenë na nuk jemi shpërngulë prej Janjevës, po kjo luftë u kanë pishane". Qaq i poshtër, se qaq ka qenë, s'u dike kush po lufton. Kanë qenë radikal, kanë qenë paramilitarë e kanë qenë kto. Po nejse, prapë ktu qysh ka qenë lufta tjetërkund na s'kemi pasë ktu ndonjë pushkatim, por tutë po.

Frikë kemi pasë, na edhe s'kemi mujtë me dalë ma se na patën blloku neve Gushterica aty, ma s'ke mujtë ti me dalë kërkah. Naltë u kanë e bllokume, knena poshtë u kanë e bllokume rrugtë. Ashtu që, jemi mbetë deri në momentin e fundit veç çka po bohet. Qe fshtarat, për shembull në Sllovi, qe Akllapin e kemi ktu. Akllapi ka qenë katuni, është mbi Janjevë edhe aty i pushkatunë. Aty i kallën, thuajqë 90 përqind i kallën, Akllapin fshatin.

**Anita Susuri:** E, a iu kujtohet koha kur kanë shku me kamiona? Qysh e kom kuptu une kroatët aq shumë kanë shku me kamiona. A iu kujtohet ajo periudhë?

**Skender Bikliqi:** Po, po. Kanë shku qaq se i kanë lanë tona senet. Çka kanë mujtë i kanë shitë, shtëpitë ende i kanë pa shitë qashtu. Janë shkatërru shtëpiat. Bile kur janë shpërngulë ata para lufte, se edhe neve na largunë prej pune, '90-at, une i kom marrë, dy makina i kom marrë prej ktyne kroatëve, "Merre, kur të dush ma jep". E une masandej, mas nja pesë...

**Anita Susuri:** Juve iu kanë dhanë kroatët makinat?

**Skender Bikliqi:** Po, makinat, une tana paret ia kom dhanë. Ia kom pa hajrin, me makinë kom punu shtipalka, lojna, kom pasë plot, hala sot e kom te shtëpia plot asi sene që kom punu lule të pllantikës e do sene me shtipalka me do sene. Kom punu do kerre të vogla qishtu edhe punë s'kisha, kërkund nuk kishim punësim edhe kom fillu kom punu deri mas lufte. Po mendoj, deri mas 1999-2000-tën, po patëm problem... une ende vazhdova me punu atë zanatin tim, por rrymë s'patëm. Rryma na sakatoi se pllastika shkriju tani kur të shkrihet, rrymë s'kishim, u nalke ajo katastrofë është, atëherë u bllokojshin maqinat. U detyrova mbas dy viteve me shitë makinat edhe që s'e kom pasë orientimin biznes fillova me tregti. Lokal, e çela, ushqimore ashtuqë...

**Anita Susuri:** Domethanë, ju masi iu kanë largu prej punës keni fillu vet me përpunim të pllantikës apo?

**Skender Bikliqi:** Po.

**Anita Susuri:** A keni pasë objektin e juj apo keni punu dikund?

**Skender Bikliqi:** Po, në shtëpi. Jo, une vet personalisht kom punu, i kom pasë maqinat, i kom pasë edhe dy punëtor i kom pasë. Kom fillu, kom startu, puna më ka shku mirë...

**Anita Susuri:** A ka pasë shumë njerëz që janë marrë me atë punë?

**Skender Bikliqi:** Pak, pak. Kush ka pasë mundësi pak. I vetmi une edhe ni shqiptarë ka qenë po edhe do kanë marrë zanate kanë punu tepsia atëherë, se u lypshin tepsiat. Kroatët shkun e kta shqiptarë kanë fillu. Sot ende është njo punon ma poshtë, punon tepsia punon çka mos, po tepsiat pak janë dalë. A mas lufte shumë ka pasë kërkesa. Veç s'kanë pasë, s'mujshin xhevap me iu dhanë. Krejt Kosova u dogj e tash tepsiat për bukë e për pite e për tonat i kanë përdorë. Ashtu kanë punu. Po edhe une kom punu deri mas lufte, dy vite, u detyrova, djalin e kom pasë çu në Angli, në Londër para lufte, ashtu që kom punu me vajzën. Mas maqinave e kom hapë ushqimore tregtinë, po edhe ktu ai lokal poshtë ma ka pasë pru edhe ktu, ky vend është i imi edhe ky, shtëpinë e kom poshtë, mirë tash. Punojmë e qishtu.

**Anita Susuri:** Deshta me iu vet për jetën e punës ktu në Janjevë. Shumica domethanë janë marrë me zanate edhe me, domethanë kanë punu në fabrikë...

**Skender Bikliqi:** Po.

**Anita Susuri:** Falë zanatit që e kanë posedu. A ka qenë kjo e vetmja mënyrë, domethanë qysh ata e kanë kalu jetën? Përpunimi i metalit apo janë marrë edhe me diçka tjetër?

**Skender Bikliqi:** Kta janë marrë, edhe me tregti janë marrë, janë marrë ma shumë edhe përpunimin e metaleve, po edhe me bujqësi janë marrë. Rreth shkollimit, te kta kroatët s'kanë dashtë, kanë pasë mundësi, të ardhura kanë pasë po kta janë orientu ma tepër në zanate. Se secila shtëpi ka pasë makina, ka pasë punëtori edhe atyne iu ka vy edhe fëmia me punu. Kanë punu edhe fëmia. Mos vet, ashtu puna u kanë. Ni pjesë ai, ni pjesë ai tjetri, me pasë pasë shtatë-tetë punëtorë atina i ka vy ashtu që i ka punësu krejt edhe shkollimi... po edhe te na ka qenë e kundërt. Na mundësi s'kemi pasë si shqiptarë me u shkollu qaq shumë, shumë pak janë shkollu gjinja, ma tepër janë punësu në fabrikë ose nëpër kta kroatët zejtarë e qishtu.

**Anita Susuri:** Po, periudha e luftës, a keni qenë ju ktu? Luftës së Kosovës, a keni qenë ktu në Janjevë apo si ka qenë në atë kohë Janjeva?



**Skender Bikliqi:** Periudhën e luftës une e kom pasë shtëpinë te “Metallci” atje poshtë. Jemi kanë tre vllazën atje edhe ni kojshi e kemi pasë. Aty në fabrikë kanë punu serbët, krejt serbët janë kanë. Kur u bo lufta, bombardimet veç na jemi detyru me ikë prej atyhit. I kom lanë shtëpiat aty krejt edhe kemi ardhë në Janjevë ktu. Se në Janjevë e kom pasë dhandrrin ktu, vajzën, ata janë kanë në Gjermani. Jemi dalë ktu kemi nejt ashtu që u detyrum me i lshu, se edhe fabrika ka qenë aty edhe serbët kanë pasë hy aty me nejt, kta ushtria. E prej atyhit kemi ikë, ktu kemi ardhë.

Ktu kemi qenë të izolom, me dalë s’kemi mujtë kërkund me dalë. Po, ktu qendër, ka pasë edhe tregu u kanë të xhumave e kemi dalë po problem nuk na kanë bo qaq shumë ktu mrena. Edhe ashtu që ktu kemi pasë si me mill si me gjanat ushqimore e kanë furnizu kta kroatët ashtu që kemi pasë ktu. Si qytetar të Janjevës nuk kemi vujtë ktu për ushqime. Por, më kujtohet na si Janjevë kemi pasë edhe shtabin ktu. Na kemi dërgu, unë kam qenë edhe nifarë Izjadin Gashi i Mramorit ka qenë inspektor edhe na prej ktuhit kemi organizu edhe kemi çu me traktora miell në Mramor. Se kur u shpërngulë Prishtina shkun ka Mramori ka anena do mjaft e na kemi organizu ktu kemi çu mjaft miell, se mullini ktu i Janjevës ka punu.

Ka qenë ni Eset ka qenë, ka qenë shumë burrë i mirë po ata s’e kanë pasë ngucë, i ka ndihmu ai shqiptarëve po edhe shkive iu ka konvenu se s’kanë pasë ku me çu me blu, i kanë thanë, “Ti ki me punu ktu”. Po, nëpërmjet atij mullini ai shumë ka kontribu, ai Eseti, edhe ashtu që çka kemi mujtë edhe na kemi kontribu. Se kemi qenë të izolom, po qaq sa kemi pasë. Une ndoshta i kom pasë pesë thasë miell, tre i kom çu i kom lanë dy për veti, qikjo ka qenë.

‘65-tën si punëtor që kam qenë zanatli, mjeshtër i mirë, ma kanë pasë dhuru edhe medaljen, osht’ edhe ni letër po kumeditë më paska ra dikund. E kom pasë shembull, medalja pune.

**Anita Susuri:** A ka pasë kështu që janë dhuru medalje punëtorëve në atë kohë?

**Skender Bikliqi:** Po, po.

**Anita Susuri:** Si ka qenë kjo?

**Skender Bikliqi:** Prej kryetarit të Titës na ka pasë dhanë... nejse, fabrika i ka cekë ata i ka caktu punëtorët. Atëherë kom pasë marrë medaljen si punëtor i mirë.

**Anita Susuri:** A kanë marrë shumë njerëz medalje të tillë a...

**Skender Bikliqi:** Kemi pasë marrë dikund njo 15 vetë. Unë kom qenë edhe atëherë kryetar i sindikatës kam qenë, i kom pasë çu edhe qysh në atë kohë ‘78-a, ‘80-ën i kom pasë çu mjaft punëtor në Ulqin e qishtu, se e kemi pasë punën e mirë, rrogat e mira. E sindikata si sindikatë e ka pasë ni pjesë damas,

fondet i kemi pasë ashtu që i kemi çu çdo vit punëtorët, kah dhetë punëtorë kah 15 punëtor i kemi pasë çu në pushime verore.

**Anita Susuri:** Na tregutë që pasi iu kanë largu prej pune jeni marrë edhe me përpunim të plastikës, po edhe me diçka tjetër a jeni marrë?

**Skender Bikliqi:** Jo, në atë kohë krejt familja më kanë punu drejt me të thanë, edhe gruaja edhe vajza kanë punu. Materialin, do material mjaft kom marrë prej Turqie, do rruza, do shnolla i kom pasë punu, i kom pasë veshë ata...

**Anita Susuri:** Si ka qenë kjo punë? A ka qenë ato mjetet apo si?

**Skender Bikliqi:** Po, i kom pasë ble ato mjetet. I kom pasë ble mjetet edhe si treg kta kanë pasë hala me shumicë kta kroatët. Ktyne ma tepër iu kom dhanë, ktyne kroatëve. Çka kom punu iu kom dhanë ktyne. Edhe drejt me thanë ia kom pa hajrin atyne po edhe masandej edhe atë maqinë që e dhashë e shita se krejt rryma ka qenë puna te na. Ndoshta iu kujtohet, rrymë s’kemi pasë kurqysh, kurqysh rrymë s’kemi pasë. Atëherë u detyrova me hjekë ato maqina, se nashta s’i kisha hjekë kurrë. Masi i hjeka maqinat tash m’u imponu, tash e kisha lokalin poshtë, se kom pasë edhe para lufte, kom pasë...

**Anita Susuri:** Cilin vit kjo?

**Skender Bikliqi:** Ky ka qenë dikur para të ‘90-ës, kom pasë lokal atëherë. Edhe punojsha në fabrikë, po edhe kisha... Marko Markoviqi kur ka qenë atëherë ka fillu Jugosllavia me pasë pak lokale qishtu i kom pasë hapë e tana fillunë prapë me mbyllë. E masandej, mbas lufte apet e hapa ushqimoren, po s’kish kush me punu...

**Anita Susuri:** Në Janjevë keni pasë dyqan apo...

**Skender Bikliqi:** Po, edhe ktu kom pasë dyqanin edhe në hymje te fabrika aty ni lokal është në të shmajtë. Kom pasë punu po edhe ktu kom punu se ktu mas lufte kta e kom ble këtë vend edhe që e prisha vendin, i bona do lokale ktu, kom fillu me punu. Deri që fillunë me shumicë se s’ka pasë atëherë Lipjani, s’ka pasë kërkush. Tash u çelën kto qendra të mdhaja. Se kta e kom pa në Turqi kur shkojsha, kur fillunë qendra të mdhaja me u hapë ato qendrat e mdhaja, lokalet, po mendoj, ushqimoret veç fillunë me u... edhe une kom pasë përcjellë atëherë edhe ktu si fillun qendrat, ETC-ja e kto, ku ta di, me u hapë edhe meniherë e kom mbyllë. Po nejse, fati apet jom kyç.

Tani në 2006-ën u hap, erdhën ktu qendra e Prizrenit deshtën me formu ni parti turke. Une e kisha dugojën ktu, erdhën. “Veç po kemi dëshirë ti me kanë”, “Une e kom lokalin s’kom kohë” edhe ashtu që u detyrova edhe me pranu kryetarin e degës atëherë. Masi fillova kryetar i degës, vajza e kish kohën për martesë thashë, “Ti gjoje çaren, martohu!” Thashë, “Leji kto punë, boll osht? Boll ke punu, ta kom pa

hajrin”. Ashtu që u detyrova... edhe lokalim ata ma dhanë meniherë me qira ktu e mora, kryetar i degës u bona edhe qe 17 vite veç ktu jemi, kjo partia si degë jemi.

**Anita Susuri:** Domethanë, ju na tregutë edhe shumë ma herët që babai juj ka qenë referent i mbrojtjes në atë kohë e ju e keni vazhdu, si me thanë, traditën e familjes politikën apo...

**Skender Bikliqi:** Po, po, qashtu. Edhe në “Metallc” sa kom qenë në fabrikë kam qenë gjithë në politikë, gjithë udhëheqës. Po edhe tash, kaniherë e ngucsha babën i thojsha, “Boll ma je marrë me...” edhe që ka dalë në pension ka qenë gjithë në aktivitete. Por edhe une, qe sot i kom bo 72 vite s’kom besu që edhe une vazhdoj. Ende jom kryesues i komunitetit në komunë jom.

**Anita Susuri:** Në Komunën e Lipjanit?

**Skender Bikliqi:** Në Komunën e Lipjanit. Se i mbajmë në çdo muj i mbajmë mledhjet çka kanë probleme të komunitetit, po janë aty edhe të LDK-së e PDK-së. Ashtu që, ne rekomandimet i bojmë në kuvend, kuvendi i aprovon e qishtu. Jom kryetar i pensionistëve të shoqatës, e qishtu do punë.

**Anita Susuri:** Na tregoni edhe pak ma shumë për kto aktivitete shembull, çka boni?

**Skender Bikliqi:** Po, kqyr, tash drejt me të thanë, na kemi startu po e kemi bo edhe nifarë, çka thojnë, temel. Tash njeri kur të ka temel edhe e çon ndërtesën sa të dush. Na masi që e kemi formu këtë partinë gjithë jom mundu që diçka të kontriboj për vendin e Janjevës ktu. Pikë së pari, mas mot moti, mas dy vjete ni rrugë atje ku janë shqiptartë, kroatët, turqit që s’kanë mujtë me kalu prej rekës [lumi], qajo pjesa naltë, se s’ka pasë as kanalizim as qishtu.

Kur i kom thirrë ata të Tikës ata, Organizata Tika, kjo ndihmon në shkolla, rrugë, në ujë besa edhe xhamia. Edhe i kom ftu ata, “Unë si degë du diçka me më ndihmu, me pasë ni respekt edhe ndaj qytetarëve”. Edhe meniherë kanë ardhë e kanë bo atë rrugën dikun 260 metra. I kanë vnu gypat një metërshe të kanalizimit, e ku ta di kta. Mas ktij meniherë rrymë s’kemi pasë atëherë... ujë s’kemi pasë na në Janjevë shumë, se edhe ujtë na patën ndërpre viteve të ‘90-a. Na e marrim ujësjellsin prej Lipjanit, shkitë për qellim të kroatëve edhe neve na patën ndërpre. Ujë s’kemi pasë, dhjetë vite s’kemi pasë ujë. Hiç kurgjo. Me puse qishtu që jemi marrë...

**Anita Susuri:** Prej cilave vite ka qenë kjo?

**Skender Bikliqi:** ‘90-ave deri në 2000, qato vite. Edhe ashtu që kemi vujtë për ujë shumë, po gjinja kanë hapë puse qishtu edhe e kanë... e masandej, mas luftime u detyrova, rrymë, tamon vike në Janjevë në Lipjan u nalke, s’kishim kurqysh lidhjet me rrymë. Jemi detyru ni gjenerator, aty në hymje poshtë prej Gushterice aty në hymje, ku ka pasë vlerë 20 mijë mark edhe ata ia kom mundësu e kemi ble. Mas atij çdo vit kom angazhu, dallim s’kom pasë, çdo vit ndoshta dy-tri herë që kemi shkepë ndihma.

Kom pasë a prej KFOR-it a prej Kryqit të Kuq a prej Tikës qishtu. Edhe kemi shkepë si kroatëve, si shqiptarëve, si turqve, romve krejtve. Ndoshta kah 100 paketa. Ose kurban mish, sidomos, ka 500 kilogram ka një mijë kilogram çdo vit i kom shkepë. Masandej ambulantës, para tri vite tash i kom thirrë i kom ftu që po kemi problem, na kanë pru, sidomos stomatologji me laborant, me tavolina me kta i kanë pru në ambulante ktu në Janjevë. E katërta xhaminë e kemi pasë katastrofë, aty ka qenë e shkapërderdhun. Kanë ardhë prej Ankarës ata ekspertat...

**Anita Susuri:** Ka qenë si e rrënune xhamia apo si?

**Skender Bikliqi:** Po, veç s'ka pasë kurqysh edhe ashtu që i kom thirrë ata i kom pru se edhe çdo ambasador që vjen, vjen edhe njoftohemi ktu e kemi kontakte. Çdo KFOR e gjeneral edhe ata vijnë e njoftohemi qishtu. Çka kemi nevojë qishtu diçka... për ma tepër, shembull si shkolla, si ambulanta, si qishtu. Besa xhaminë shumë mirë, bile edhe kta kroatët vet thojshin, "Rregullone bre kit' xhami Skender, marre". Une kur kanë pasë ardhë prej Ankarës gjithë i kom çu te kisha edhe ambasadorin, "Merrni nasijat [mësim], kqyrni çfarë kishe o e kqyrne xhaminë në qendër". Edhe e kanë marrë seriozisht edhe e kanë kry dikund kur vlera është 700 mijë euro.

Po edhe komuna atë, se ka qenë rekë aty s'kemi mujtë me kalu, krejt ata komuna na dha veç a mundesh me punu. Ashtu që, kemi punu. E kanë bo projektin edhe s'jom perzi ma. Deri aty e kom pru tjetër, ju vazhdone punën une kom tjera obligime ashtuqë mirë ka qenë aty. Tash, sivjet, në shkollë kemi qenë e kom thirrë kta KFOR-in turk. Shkolla është katastrofë, as banka s'kanë. Dritaret janë të drunit. Tash besoj që këtë muj e ta kqyrim, duhet me ardhë ai, se ata e bojnë projektin e qojnë në Turqi e masandej kthehen a p'e përkrahin a jo. E po m'doket që e kanë përkrah shkollën me bo ni restaurim komplet shkollën.

**Anita Susuri:** Shkollën e re?

**Skender Bikliqi:** Shkollës së re. Besa, komuna tash vjet se kur i prunën kta mjetet edhe komunën e kanë ly, se komuna si komunë, po edhe aty e kanë gëlqerosë, i kanë qit stiropor e kanë bo fasadimin e krejt e kanë bo komunë...

**Anita Susuri:** Tash ku është policia apo?

**Skender Bikliqi:** Te komuna, bash te komuna aty. Qajo objekti i komunës.

**Anita Susuri:** Ku është ai objekti?

**Skender Bikliqi:** Te policia aty, a keni qenë në komunë?

**Anita Susuri:** Po, kemi qenë aty.

**Skender Bikliqi:** Në hyrje të komunës, krejt tash, se ka qenë komuna mos vet, nifarë gëlqerosje ka pasë po kta e kanë qit me steropor, me fasadë, me, e kanë rregullu, vjet e kanë rregullu ata. E po du me thanë që pa marrë parasysh është mirë, kushdo le të jenë, une kaq parti e vogël në Janjevë që jom po secili le të kontribuon pak diçka krejt kanë me i mbetë këtij vendi. Xhamia i jet', ambulanta i jet', komuna i jet'. Dikun kanë me dhanë po kush është i zoti, kush i ka njerstë munet me përfitu edhe donacionet. E une gjithë, pak jom vjetru, pak po tash hala s'po më lshojnë ata, "Mirë je ktu, rri ktu". Kshtu që, jom mundu për kta qytetartë, se sa për veti une i kom renet e mira, djalin e kom në Londër, vajzat i kom jashtë do, punët i kom mirë.

**Anita Susuri:** Domethanë, fëmitë nuk i keni ktu?

**Skender Bikliqi:** A?

**Anita Susuri:** Në Janjevë fëmijët nuk i keni?

**Skender Bikliqi:** S'i kemi, veç me gru jam. Qe 20 vite jam me gru ktu, nashta ma tepër. Por, vajzat i kom përcjellë. Secila punon, i kanë puntë mirë. Unë i kom edhe ktu lokalet, e kom edhe shtëpinë poshtë, vendi i mirë është me oborr e me kta ashtu që...

**Anita Susuri:** A keni edhe diçka me shtu nëse kemi harru?

**Skender Bikliqi:** Vallahi, veç kisha dashtë me shtu që me pasë ni mirëkuptim, ni bashkëpunim. Sa ka qenë para shumë ma lehtë kemi punu, e tash shumëpartiak e kurgjo s'po mujm punojmë. Veç kta po du me cekë se me kanë si Janjeva hala ni asambleist qe sa vite s'janë ka e përfitojnë me shku në komunë, pa marrë parasysh se kush. Se me kanë ni asambleist sado kudo ni votë e tina mjafton e lufton për vend të vet. E na hala asni asambleist, hala as LDK-ja, as PDK-ja janë kah dalin ndoshta dy mijë vota ktu e ti sot me 500 vota del ni asambleist atje. Po thom kaniherë shpesh, "O të mirremi vesh se kurgjo nuk lun rol ni karrikë, po është me rëndësi qytetarëve me iu bo mirë, qytetarët me ta pa hajrin dikun, qajo është me rëndësi".

Drejt me të thanë edhe me i shkollu i kom, mjaft në fakultet i kom regjistru, fëmitë, vajzat, djemtë. Në FSK besa, shtatë vetë i kom punësu që sot osht' ni familje me punësu. Ashtu që, po thom ni mesazh, ni bashkëpunim, ni mirëkuptim se rinia po na vujnë. Për këtë rini, se une për veti sot e kisha lanë. Me pasë ni i ri... une besa edhe i kom shkollu, nja, ni magjister ka dalë, ni doktoraturë e ka kry po nuk ia kanë gjetë ktu punën shkun në Shqipni. "Une e kom kry me ardhë në Kosovë, e jo për Shqipni".

E ashtuqë... nejtse, ata janë gjetë, e kanë gjetë vendet e punës, po me ardhë ni djalë i ri që është ekspert që mundet me kontribu me pasë Janjeva ndonjë kuadër, a din sa, me bo projektet, se kta

projektet faktikisht gjatë vitit dojnë me i dhanë dikund po kur s'e ki projektin... a me pasë projektin e dorëzon paret janë aty. E gjinja qishtu përfitojnë se jom provu me kta edhe tash e jom.... Faleminderit edhe prej juve.

**Anita Susuri:** Faleminderit shumë.